




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2.0/DPK
Dep. 01-1272/13
Nr. llog. 02
Broj stranic 02
Nr. pages 02
Date 25.04.2013
PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	25.04.2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Ragip Zejnullahu Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit
CC:	z. Shukri Buja Kryetar i Komunës së Lipjanit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për tenderin "Furnizimi me material dhe pajisje të imta për mirëmbajtjen e objekteve të institucioneve komunale" Ritender II

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin "Furnizimi me material dhe pajisje të imta për mirëmbajtjen e objekteve të institucioneve komunale" me numër prokurimit me nr: **920 013 005 121**, ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, (në tekstin e mëtejme AK), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin Publik "Furnizimi me material dhe pajisje të imta për mirëmbajtjen e objekteve të institucioneve komunale", në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit në Komunën e Lipjanit, si autoritet kontraktues, ka përgatitur njoftimin për kontratë dhe e ka publikuar në ëeb faqen e KRPP me datën 26.03.2013, për tenderin me titull "Furnizimi me material dhe pajisje të imta për mirëmbajtjen e objekteve të institucioneve komunale" me nr : prokurimi 920 013 005 121, në procedurë të hapur. Procedura e prokurimit ka filluar me kërkesën e njësisë kërkuese konkretisht nga Drejtori i Arsimit në KK Lipjan të bërë me datën 01.02.2012, kërkesës i është bashkangjitur edhe specifikacioni i mallrave. Nga Kërkesat për Kryerjen e Furnizimeve të nënshkruara nga drejtorët e shkolla përkatëse, drejtori i departamentit dhe nga Kryetari i Komunës, krijohet një listë e gjatë e artikujve të domosdoshëm dhe dorëzohet në këtë Drejtori. Ndërsa pas pranimit të këtyre kërkesave Drejtoria e Arsimit nuk i ka përfshirë disa artikuj të kërkuar nga shkolla në specifiacion përfundimtar dhe për këtë nuk ka dhënë asnjë sqarim me shkrim. Gjithashtu ne **specifikacionin përfundimtar janë te përfshirë artikuj te cilete nuk janë kërkuar nga shkollat, nder të tjerat edhe aparat saldues.**

Zyra e prokurimit me datë 26.03.2013 ka përgatitur Dosjen e Tenderit për kontratën publike Kornizë-furnizim me një operator, dhe specifikimin e materialit për mirëmbajtje të objektit sipas kërkesës se vetme të bërë nga njesia kërkues përkatesishte Drejtoria e Arsimit. Agjencise kundër Korrupsioni nuk i është ofruar asnjë dokument tjetër qe dëshmon se ekzitojnë edhe kërkesat të departamenteve tjera për furnizim me material të mirëmbajtjes, andaj tiulli i kontratës për këtë aktivitet të prokurimit duhet të harmonizohet me kërkesën e njësisë kërkuese.

Në faqen 45 te Dosjes se Tenderit ku përshkruhet specifikimi i materialit per mirëmbajtjen e objekteve janë përshkruar artikuj të cilët nuk janë kërkuar nga shkollat dhe as nga Drejtoria e Arsimit, por Zyra e Prokurimit i ka përfshi në dosje për të cilat nuk ka kërkesë për furnizim. Autoriteti Kontaktues në Dosjen e Tenderit nuk ka paraqitur **specifiakimet teknike** të cilat duhet të përmbushen në këtë tender sipas objektit të kontratës. Mos specifikim i saktë i karakteristikave të disa artikujve në Dosjen e Tenderit u ka dhënë mundësi operatoreve vete apo në bashkëpunim të ofertojnë me çmim më të ultë se çmimi i tregut. Me veprimet e tilla Autoriteti Kontaktues nuk ka respektuar këto dispozitat:

Dispoziata e nenit 27, dhe nenit 28 të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Në seksionin II. Fleta e të dhënave të tenderit konkretisht në pjesën e Aneksit 6. te kriteret për dhënien e kontratës ka përcaktuar kriteret të pa matshme dhe në kundërshtim me ligjin, në kategorinë 2 të Aneksit 6. Të Kriterëve për dhënien e Kontratës është përcaktuar si kriter i pamatshëm Qarkullimi bankar. Me një veprim të tillë autoriteti kontraktues nuk ka respektuar dispozitat:

Dispoziata e nenit 52 te Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Me respekt!